



Takimi ndërkulturor në kafene për prindërit

„Bëhu ndryshimi që dëshiron të shohësh në botë“ (Mahatma Gandhi)



Takimi ndërkulturor në kafene për prindërit është një program arsimor, ku kryesisht ka për qëllim prindërit por edhe institucionet arsimore / organizata / shoqata të ndryshme në të cilat zhvillohet programi / projekti.

Prindërit do të ftohen në institucionin arsimor të fëmijëve të tyre apo në ndonjë shoqatë të emigrantëve, ku aty do të zhvillohet një ligjeratë e caktuar nga referentja/referenti dhe ku poashtu mund të shqyrtohet ligjerata me prindërit. Në këtë mënyrë, tentohet që prindërit t'i përforcojnë kompetencat e tyre të prindërimit dhe shkollimit, gjegjësisht të aprovohet bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet shkollave/çerdheve, prindërve dhe fëmijëve, në mënyrë që disa sfida të zgjidhen më lehtë, gjegjësisht të përcillen më mirë fëmijet në sistemin arsimor Austriak.

Qëllimet

- Mbështetje në rrugën edukative dhe arsimore të prindërve përkatës
- Rritje të bashkëpunimit mes shkollës përkatëse dhe prindërve në shtëpi
- Përforcim të vetëbesimit dhe vetëvlerësimit, të prindërve pjesëmarrës
- Mbështetja e prindërve në qasje me institucionin shkollor të fëmijëve të tyre
- Zgjerimi i mundësive arsimore të fëmijëve, të prindërve që marrin pjesë në takim
- Përforcimi i aftësive sociale dhe ndërkulturore/integritit, të të gjithë pjesëmarrësve
- Mbështetje të ndërsjellët për njëri-tjetrin në shoqërinë e përbashkët

Oferta e programit

Takimi ndërkulturor në kafene për prindërit mbahet deri në tetë herë në vitin shkollor me nga dy njësi mësimore (50 min. një orë mësimore) në interval të rregullt. Zhvillimi i programit mbahet në vende të ndryshme të Austrisë së sipërme. Ky program/projekt zhvillohet nga referentët e institutit ndërkulturor pedagogjik Volkshochschule OÖ. Në rast nevojë mund të organizohet edhe kujdestari për fëmijë. Këtu zhvillohen shumë tema rreth edukimit, shkollimit, shëndetësisë, mediave sociale, të drejtat e njeriut, shumë gjuhësia, kulturave të ndryshme etj.